

Gjuha e lehtë

Të drejtat e punësimit për personat me aftësi të kufizuar

Udhëzime



Falenderojmë anëtarët e shoqatës

Klubi Dëshira

Grupi Kontrollues:

Lumnije Demolli

Qëndrim Jashari

Driton Krasniqi

Hasan Krasniqi



© European Easy-to-Read Logo: Inclusion Europe.

Më shumë informata në:

www.inclusion-europe.eu/easy-to-read

Gjuha e lehtë do të thotë që teksti është i kuptueshëm dhe i arritshëm për të gjithë, pavarësisht nga aftësia intelektuale apo pengesa të tjera për të kuptuar.

Shënim: Përmbajta e kësaj broshure është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk pasqyron detyrimisht pikëpamjet e Renovabis dhe Caritas Austria.

Hyrje



Kjo broshurë ju ndihmon të kuptoni më mirë të drejtën tuaj për punësim.



Broshura përmban të gjitha ligjet që ju premtojnë punësimin.

Konventa e personave me aftësi të kufizuar




Konventa e nënshkruar më 2007 nga shtetet e Organizatës të Kombeve të Bashkuara detyron shtetet në botë të respektojnë barazinë e gjithë njerëzve.



Kjo konventë na thotë që personat me aftësi të kufizuar kanë të drejtë të punësohen.

Sipas konventës personat me aftësi të kufizuar duhet të trajtohen njëjtë si të gjithë njerëzit e tjerë.



Konventa thotë që secili prej nesh ka të drejtë të zgjedhë punën që dëshiron dhe t'a sigurojë jetesën e vet.



Konventa spjeron që vendi i punës duhet të jetë i përshtatshëm dhe ndihmues për personat me aftësi të kufizuar.

Poashtu personat me aftësi të kufizuar duhet të ndihen të vlerësuar dhe të pranuar kur janë duke kërkuar punë dhe mbasi të punësohen.



Ligji 27 i Konventës ju premtan këto të drejta:

- të punoni në vende të njëjta me të gjithë njerëzit e tjerë,



- të merrni pagesë të njëjtë me të gjithë të tjerët që punojnë në të njëjtin vend të punës

- shteti duhet të ju ndihmoj kur kërkoni punë,

Asistencë në Punësim



- ju ndihmon që të hapni biznesin tuaj,

- ju jep të drejtën të punoni në sektorin privat dhe publik.



Ligji për drejtat e punësimit për personat me aftësi të kufizuar të Republikës së Kosovës

Ligji për të drejtat e punësimit për personat me aftësi të kufizuar kontrollonhet nga Ministria e Drejtësisë dhe është i bazuar në Konventë.



Ky ligj na thotë që ju keni të drejtë të punoni dhe duhet të jeni të lirë si çdo qytetar tjetër.

Investim në Punësim




Sipas këtij ligji shteti duhet të jap të holla për punësimin e personave me aftësi të kufizuar.




Ligji thotë që Qendra për përgatitje profesionale duhet të ju ndihmoj në:

- përgatitjen tuaj profesionale, bazuar në nevojat e tregut të punës;



- krijimin e kushteve të përshtatshme për punësimin tuaj;

- ofrimin e trajnimeve që ndihmojnë në përgatitjen tuaj;



Në rast se nuk i gëzoni këto të drejta atëhere mund të ankoheni.

Ankesën mund ta bëni tek institucioni i Avokatit të popullit:



Telefoni: 038223782

Email: info.oik@oik-rks.org

Adresa: Rruga Migjeni, 10000
Prishtinë.



Për të përmirësuar punën, ju lutemi vlerësoni tekstin.
Këtë mund ta bëni duke skanuar kodin QR ose
nëpërmjet lidhjes:

<https://forms.gle/CXiTFVyn91Vxd4wJ8>



**CARITAS
KOSOVA**

Përgatitur: Caritas Kosova

www.caritaskosova.org / 383 (0) 290 328 110

info@caritaskosova.org

**Adresa: Rr. Shën Nënë Tereza Nr. 3/Kisha Katolike
70000 Ferizaj, Kosovë**